



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 64

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Prishtinë, më 6 mars 2013, në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa dhe Flora Brovina.

Mungoi: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj– administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i lartë i fushës për shëndetësi; Xheneta Sopjani-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.02.2013;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë;**
4. **Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.02.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës 27.02.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Fikrim Damka- Tha se grupi i punës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka hartuar disa amendamente.

Bahri Thaçi- Në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës për këtë projektligj, tha se grupi ka mbajtur disa takime, gjatë të cilave e ka shqyrtuar në hollësi këtë projektligj. Si rezultat i këtyre takimeve, i kemi hartuar disa amendamente, të cilat ju ftoj që t'i votojmë.

Liburn Aliu- Tha se unë kam vërejtje në nenin 10 të projektligjit. Ne e kemi diskutuar shumë këtë nen. Ky paragraf nuk është shumë i qartë, sa i përket kompetencës së personit që merret me sigurinë në punë. Kush e përcakton dijen/kompetencën e tij? Duhet të dihet përgjegjësia dhe në këtë rast shteti duhet të marrë përgjegjësinë që i takon për mbrojtjen e punëtorëve. Këtu nuk precizohet se këta persona duhet të licencohen për një punë të tillë. Shumica dërmuese në Kosovë punojnë në ndërmarrje me më pak se 50 punëtorë.

Time Kadriaj- Tha se ne e kemi diskutuar këtë çështje në takimin që e kemi pasur me përfaqësuesit e MPMS-së. Për mua është i qartë teksti i projektligjit.

Bahri Thaçi- Tha se ne nuk kemi dashur t'i ngarkojmë shumë bizneset e vogla, duke iu kërkuar për ta punësuar dikë që merret enkas me sigurinë në punë. Në bazë të këtij ligji, shumë mirë definohej këto çështje, por është çështje tjetër se sa është Inspektorati azhur në punën e tij.

Liburn Aliu- Tha se në projektligj, nuk thuhet se personi që merret me sigurinë në punë duhet të jetë i licencuar, por thotë se personi vetëm duhet t'i plotësojë kushtet. Kush e përcakton se ai njëmend i ka plotësuar kushtet? Unë jam që të mos e ngarkojmë biznesin, por unë dua që punëtorët të kenë mbrojtje adekuate. Procedurat për licencim duhet të thjeshtohen, por jo që punëtorët të mbesin pa mbrojtje.

Gëzim Kelmendi- Tha se kjo është çështje komplekse. MPMS-ja na ka thënë se është e pamundshme të licencohen të gjithë punëdhënësit e ndërmarrjeve të vogla. Duhet të specifikohet lloji i veprimtarisë, sepse nuk janë të gjithë punëtorët në mënyrë të njëjtë të rrezikuar.

Nazane Breca- Nga përfaqësuesit e MPMS-së na është thënë se është e pamundur të specifikohen të gjitha veprimtaritë. Problemi që po ngrihet është se kush do ta mbajë trajnimin e këtyre personave që merren me sigurinë në punë. Fjalën “certifikim” nuk duhet ta heqim, por vetëm duhet ta shtojmë edhe fjalën “licencim”.

Salihe Mustafa- Tha se në nenin 9, sqarohet kjo çështje dhe të shohim nëse keni ndonjë propozim konkret për rregullimin e kësaj çështjeje.

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash, i miratoi këto amendamente:

Amendamenti 1

Në nenin 2, paragrafi 2, fshihen fjalët "punëtorët fillestarë".

Amendamenti 2

Në nenin 2, paragrafi 3, riformulohet si vijon:

3. "Dispozitat e këtij Ligji nuk zbatohen në sektorët, veprimtaria e të cilëve rregullohet me ligje të veçanta, si: forcat e armatosura, policia, shërbimi i zjarrfikësve dhe forcave për mbrojtje dhe shpëtim. Në këto raste, siguria dhe shëndeti në punë duhet të sigurohen sa më shumë të jetë e mundur, në përputhje me kërkesat e këtij ligji".

Amendamenti 3

Në nenin 3, paragrafi 1.3, fshihet fjala "punëmarrësve" dhe zëvendësohet me fjalën "punësuarve".

Amendamenti 4

Në tërë tekstin e projektligjit, pas fjalës "fizike" dhe "kimike", shtohet fjala "biologjike".

Amendamenti 5

Në nenin 3, në paragrafin 1.7, të fshihet togfjalëshi "rreziqe profesionale" dhe në vend të tij shtohet teksti i ri, si vijon: "rreziqet që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së punës".

Amendamenti 6

Në nenin 3, paragrafi 1.11, fshihet fjala "certifikuar" dhe zëvendësohet me fjalën "licencuar".

Amendament 7

Në nenin 3, paragrafi 1.12, në fund të paragrafit, fshihet fjalia: "i cili nuk rrjedh nga sëmundjet e përgjithshme" dhe zëvendësohet me: "që lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së punës".

Amendamenti 8

Në nenin 3, paragrafi 1.13, riformulohet si vijon: "Inspektorati i punës është trup ekzekutiv i MPMS-së, që mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të punës, përfshirë edhe këtë Ligj".

Amendamenti 9

Në nenin 4, paragrafi 1, pas togfjalëshit: "Qeveria e Republikës së Kosovës" shtohet tekst, si vijon: "në bazë të propozimit të Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale".

Amendamenti 10

Në nenin 4, paragrafi 2, fshihet fjalia: "dhe dy ekspertë nga lëmitë e tjera përkatëse" dhe zëvendësohet me tekstin, si vijon: "një ekspert i mjekësisë së punës dhe një ekspert ad hoc, varësisht nga natyra e çështjes".

Amendamenti 11

Në nenin 4, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri, si vijon: "Mandati i anëtarëve të Këshillit është tre (3) vjeçar".

Amendamenti 12

Në nenin 7, paragrafi 1.6, para fjalës "monotone" shtohet fjala "e njëtrajtshme" dhe fshihet fjala "të përsëritshme".

Amendamenti 13

Në nenin 9, paragrafi 1, në fund të paragrafit shtohet teksti, si vijon: "nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj".

Amendamenti 14

Në nenin 9, paragrafi 5, riformulohet si vijon:

5. "Ministria, me akt nënligjor, varësisht prej llojit të veprimtarisë, përcakton kushtet dhe kriteret, për certifikimin dhe licencimin e personave dhe institucioneve për shërbime nga paragrafi 4 i këtij neni".

Amendamenti 15

Në nenin 15, paragrafi 1, para nënparagrafit 1.1, të shtohet një nënparagraf i ri me këtë përmbajtje: "Secila ndërtesë t'i ketë daljet emergjente".

Amendamenti 16

Në nenin 15, paragrafi 1.7, të fshihen fjalët: "dhoma për pirjen e duhanit".

Amendamenti 17

Në nenin 23, paragrafi 8, riformulohet dhe ndahet në dy paragrafë, si vijon:

8. Bazuar në pasojat, aksidentet në punë klasifikohen si më poshtë:

8.1. aksidente të cilat shkaktojnë paaftësi të përkohshme për punë;

8.2. aksidente të cilat shkaktojnë paaftësi të përhershme në punë;

8.3. aksidente me pasojë vdekje në punë;

9. Bazuar në numrin e personave të lënduar në punë, aksidentet në punë klasifikohen si më poshtë:

9.1. aksidente individuale, kur lëndim në punë pëson vetëm një i punësuar;

9.2. aksidente masive ku të paktën dy apo më shumë të punësuar lëndohen në të njëjtën kohë dhe për shkak të arsyeve të njëjta.

Amendamenti 18

Në nenin 26, paragrafi 1, në fund të fjalisë shtohet teksti si vijon: “ në afat prej gjashtë muajsh”.

Amendamenti 19

Në nenin 27, fshihet fjalia “përkatësisht me fillimin e zbatimit të tij”.

4. Të ndryshme

Time Kadriaj- Tha se e kemi marrë një njoftim dhe një ankesë. Njoftimi ka të bëjë me Institutin e Politikave Sociale. Ankesa është nga Oda e veterinarëve. Ne jemi takuar disa herë me këtë odë, por tashmë është vonë për të ndërmarrë diçka lidhur me përfshirjen e tyre në Ligjin për Odat e profesionistëve shëndetësorë.

Nazane Breca- Tha se kërkesa për përfshirjen e tyre ka qenë e vonshme.

Liburn Aliu- Tha se kërkesa e drejtuar nga Instituti i Politikave Sociale i referohet Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Flora Brovina- E informoi Komisionin për takimin e zhvilluar në MPMS, në kuadër të monitorimit të Ligjit për aftësimin dhe riaftësimin e personave me aftësi të kufizuara.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka